



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 15.05.2017,
e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi, shef i GP-së (LDK), Flamur Shala (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Shefqet Sylejmani (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahimimi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hetem Kupina (LDK), Merita Surkishi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Berat Lahu (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Shaip Shabani (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Egzona Podvorica (PDK), Mirlinda Sopi, shefe e GP-së (AKR), Sami Boroci (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Abetare Fazliu, përfaqësues e subjektit politik (LB), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP) dhe Abit Kastrati.

Mungoi: Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD).

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.
Kryesuesi e hapi diskutimin për rendin e ditës.

Kryetari, Shpend Ahmeti, kërkoi që të mbahet një minutë heshtje me rastin e vdekjes së gazetarit Ganimet Klaiqi.
Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se ne si ekzekutiv propozojmë që ta tërheqim pikën e shtatë të rendit të ditës:

“Propozimvendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e depos, ku do të trajtohen mbetjet e materialeve ndërtimore”, parcela 19-0, ZK Drenoc, meqenëse materiali nuk është gati, dhe këtë do ta përgatisim për mbledhjen e radhës.

Kryesuesi tha se nuk do ta qesim në votim këtë pikë të rendit të ditës, pasi që ekzekutivi propozon që të tërhiqet pika e shtatë e rendit të ditës.

Agim Gashi po ashtu propozoi që pika e shtatë të hiqet nga rendi i ditës, si dhe pika e gjashtë: “Propozimvendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e objekteve shumëbanesore”, parcelat: 1180-1, 1185-1, 1183-2, 1184-1, 1178-0, 1177-0, 1179-0 dhe 1176-OK Bernicë e Epërme, po ashtu të hiqet edhe pika e dymbëdhjetë: “Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ambasadës së Republikës së Shqipërisë. Ne mendojmë se edhe për këto pika materiali nuk është i nevojshëm, sidomos për pikën dymbëdhjetë, sepse mendojmë që kjo pikë duhet të shtyhet dhe të procedohet në përputhje me ligjet përkatëse që e rregullojnë këtë fushë.

Muhamet Selmani, sa i përket deponisë që është planifikuar të ndërtohet në fshatin Barilevë, tha se banorët nuk janë të informuar lidhur me këtë. Banorët kanë kërkuar informacione shtesë se çfarë lloj deponie planifikohet të ndërtohet aty, çfarë lloji është përpunimi i atyre materialeve dhe cili është niveli për përpunimin e atyre materialeve. Po ashtu, nuk jam i pajtimit për këtë pikë që të vihet në rend të ditës, pa e pasur një aprovim nga Ministria e Planifikimit dhe nga Ministria e Bujqësisë, se a është e lejueshme që të ndërtohet një deponi e materialeve inerte në një pjesë e cila është tokë bujqësore. Po ashtu, kërkoj që pika e njëmbëdhjetë të hiqet nga rendi i ditës: “Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme Komunale në shfrytëzim NPL “Hortikultura”, meqenëse kjo ndërmarrje nuk është funksionale, nuk e pranojnë futjen e aksionarëve dhe nuk lejohet zgjedhja e bordit.

Lirak Çelaj theksoi se për pikën e gjashtë kam kërkuar interpretime shtesë se çka është, cila është ideja, cili është synimi dhe si do të procedohet. Është premtuar nga nënkryetari se për këtë mbledhje do të na dërgohet materiali shtesë. Unë nuk po e shoh që ka ardhur materiali, dhe në këtë mënyrë po dalim para aktit se nuk po dimë çka po votojmë! Sa i përket çështjes së Ambasadës së Shqipërisë, unë nuk e pata të qartë prej materialit, ndoshta mundeni me na shpjeguar, për cilin parcelë, se ishte ajo te Sofalia, hartën nuk e kuptova se për cilën pjesë është fjala. Jemi për ta hequr pikën e gjashtë, ndërsa për pikën e njëmbëdhjetë të merren informata.

Qëndron Kastrati tha se kërkesa për heqjen e pikës së gjashtë nga rendi i ditës, për ne është absolutisht e papranueshme. Jemi të shqetësuar që po bllokohen proceset dhe projektet e mëdha, vetëm që të ikin afatet ligjore dhe të mund të bllokohet një proces i tillë. Kjo gjithashtu vlen edhe për Ambasadën e Shqipërisë. Ne propozojmë që si pikë, para pikës “Pyetje dhe përgjigje”, të jetë “Shqyrtimi i punës së anëtarëve të komisioneve komunale të aksionarëve”, që të hyjë në votim dhe të diskutojmë në raport me këtë çështje. **Shemsi Veseli** tha se nuk është e vërtetë që nuk kemi dërguar materiale, kryetari është në dijeni për këtë. Aty ku jam unë, në “Sport - Marketing”, e di saktësisht që ka raporte.

Pra, është e paqëndrueshme ajo që po thotë që nuk ka raporte prej aksionarëve. Të përgatitet materiali dhe në mbledhjen e ardhshme të diskutojmë.

Kryetari, Shpend Ahmeti, dha sqarime sa i përket pikës së dymbëdhjetë, për dhënien e pronës në shfrytëzim për ndërtimin e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës. Vendimi është i njëjti që ka qenë herën e fundit, ku nuk është votuar, dhe ka të bëjë me rrugën "Fehmi Agani".

Sot kemi të bëjmë me afatin e fundit për dhënie të pronës në shfrytëzim afatgjatë. Pas kërkesave të vazhdueshme, kemi vendosur që ta sjellim edhe njëherë në mbledhje të Kuvendit.

Sa i përket pikës së gjashtë, e cila ka të bëjë me Propozimvendimin për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e objekteve shumëbanesore, janë parcela ku mendojmë se do të bëhet zgjidhja e banimit për punëtorët e sektorit publik në Komunën e Prishtinës. Po ashtu, preken mbi 6000 punëtorë që potencialisht mund të jenë përfitues të skemës. Prej kësaj do të përfitojnë mbi 400 punëtorë të sektorit publik të komunës së Prishtinës, banim me kosto të përbalueshme, në qoftë se e japin dhe kontribuojnë për më shumë se 10 vjet në sektorin publik.

Kryesuesi ceku se kemi propozimin e Agim Gashit, që pikat 6 dhe 12 të hiqen nga rendi i ditës.

Kemi propozimin e Muhamet Selmanit, që pika 11 të hiqet nga rendi i ditës.

Qëndroni propozoi që të futet në rend të ditës pika "Shqyrtimi i punës së Komisionit të aksionarëve".

Kryesuesi konstatoi se më 24 (njëzet e katër) vota për, 24 (njëzet e katër) vota kundër, (Abetare Fazliu, Abit Kastrati, Bardha Dida Rogova, Berat Lahu, Cuneyd Ustaibo, Feti Mehdiu, Genc Sherifi, Hatixhe Hoxha, Hatixhe Latifi - Pupovci, Hazir Borovci, Imer Rusinovci, Kimet Zeqa, Mirlinda Sopi, Nenad Miladinoviqi, Qëndron Kastrati, Remzi Pacolli, Rita Begolli, Sadri Ramabaja, Sami Boroci, Sofije Bunjaku, Sylejman Pireva, Teuta Krasniqi, Visar Arifaj, Ylli Hoxha), 2 (dy) abstenime, (Shefqet Sylejmani, Halim Halimi), hiqet nga rendi i ditës pika e gjashtë: "Propozimvendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e objekteve shumëbanesore, parcelat: 1180-1, 1185-1, 1183-2, 1184-1, 1178-0, 1177-0, 1179-0 dhe 1176-0K, Bernicë e Epërme.

Kryesuesi e përkrahu heqjen e kësaj pike nga rendi i ditës, sepse materialet kanë ardhur me vonesë.

Merita Surkishi propozoi që si pikë shtesë në rend dite të jetë edhe: "Propozimvendimi për caktimin e një anëtari në Komisionin komunal të aksionarëve".

Kryesuesi konstatoi se më 17 (shtatëmbëdhjetë) vota për, 29 (njëzet e nëntë) vota kundër (Abetare Fazliu, Abit Kastrati, Bardha Dida - Rogova, Berat Lahu, Blerand Stavileci, Cuneyd Ustaibo, Egzona Podvorica, Fadil Gashi, Feti Mehdiu, Genc Sherifi, Hatixhe Hoxha, Hatixhe Latifi - Pupovci, Imer Rusinovci, Kimet Zeqa, Laura Zherka, Lirak Çelaj, Lirie Avdiu, Mirlinda Sopi, Muhamet Selmani, Qëndron Kastrati, Remzi Pacolli, Rita Begolli, Sadri Ramabaja, Sami Boroci, Shemsi Veseli, Sofije Bunjaku, Sylejman Pireva, Teuta Krasniqi, Ylli Hoxha) dhe 2 (dy) abstenime, (Nenad Miladinoviqi dhe Agim Gashi), Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ambasadës së Republikës së Shqipërisë, mbetet pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e Qëndron Kastratit.

Kryesuesi konstatoi se më 19 (nëntëmbëdhjetë) vota për, 25 (njëzet e pesë) vota kundër, (Abit Kastrati, Agim Gashi, Besa Rafuna, Blerand Stavileci, Egzona Podvorica, Fadil Gashi, Fisnik Osmani, Halim Halimi, Hasime Krasniqi, Hazir Borovci, Hetem Kupina, Imer Rusinovci, Laura Zherka, Lirak Çelaj, Lirie Avdiu, Muhamet Nura, Muhamet Selmani, Naime Osmani, Rita Begolli, Shaip Hajrizi, Shaip Shabani, Shefki Gashi, Shemsi Veseli, Vjollca Dibra - Ibrahim, Vlora Dumoshi), dhe 5 (pesë) abstenime, (Ajnishahe Azemi, Merita Surkishi, Shefqet Sylejmani, Visar Arifaj, Feti Mehdiu) nuk hyn si pikë e rendit të ditës "Shqyrtimi i punës së anëtarëve të komisionit të aksionarëve në ndërmarrjet publike lokale".

Lirak Çelaj propozoi që pika e cila ka të bëjë me komisionin e aksionarëve, të jetë pikë e parë e rendit të ditës.

Muhamet Selmani propozoj që të hiqet pika e njëmbëdhjetë nga rendi i ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 8 (tetë) vota për, 37 (tridhjetë e shtatë) vota kundër, (Abetare Fazliu, Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Bardha Dida - Rogova, Berat Lahu, Besa Rafuna, Cuneyd Usataibo, Feti Mehdiu, Fisnik Osmani, Flamur Shala, Genc Sherifi, Hasime Krasniqi, Hatixhe Hoxha, Hatixhe Latifi Pupovci, Hazir Borovci, Hetem Kupina, Imer Rusinovci, Kimet Zeqa, Merita Surkishi, Mirlinda Sopi, Muhamet Nura, Mustafë Krasniqi, Naime Osmani, Qëndron Kastrati, Remzi Pacolli, Rita Begolli, Sadri Ramabaja, Sami Boroci, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Shefqet Sylejmani, Sofije Bunjaku, Sylejman Pireva, Teuta Krasniqi, Visar Arifaj, Vlora Dumoshi, Ylli Hoxha), 2 (dy) abstenime, (Nenad Miladinoviqi, Halim Halimi), mbetet si pikë e rendit të ditës "Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPL " Hortikultura".

Kryesuesi konstatoi se më 24 (njëzet e katër) vota për, 1 (një) votë kundër, (Imer Rusinovci), 2 (dy) abstenime (Nenad Miladinoviqi dhe Visar Arifaj), hynë si pikë e parë e rendit të ditës "Caktimi i një anëtarë në Komisionin komunal të aksionarëve në KRM "Pastrimi".

Qëndron Kastrati ngriti shqetësim rreth votimit të anëtares së Kuvendit znj. Vjollca Dibra - Ibrahim, duke thënë se është shumë e rëndësishme që të verifikohet se a ka qenë kartela e saj e vendosur në momentin kur ka hy ajo në sallë, sepse nuk ka qenë prezent në sallë, por është sistemi i cili e verifikon a është vendosur kartela në atë kohë ose jo, nëse po, atëherë kërkojmë përgjegjësi.

Kryesuesi konstatoi se me ndryshimet dhe propozimet e dhëna, më 29 (njëzet e nëntë) vota për, 14 (katërmbëdhjetë) vota kundër, (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Besa Rafuna, Fisnik Osmani, Flamur Shala, Hasime Krasniqi, Hazir Borovci, Hetem Kupina, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Mustafë Krasniqi, Shefqet Sylejmani, Vjollca Dibra - Ibrahim, Vlora Dumoshi), 2 (dy) abstenime (Visar Arifaj dhe Sylejman Pireva), u miratua ky

REND I DITËS :

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së parë dhe të dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për caktimin e një anëtar të Komisionin komunal të aksionarëve në KRM "Pastrimi";
3. Shqyrtimi i raportit tremujor financiar, janar-mars 2017;
4. Bartja e buxhetit të pashpenzuar të të hyrave vetjake nga viti 2016 në vitin 2017;
5. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim për raste të veçanta të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me prona të paluajtshme të personave fizikë;
7. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re" - Zona Lindje;
8. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1";
9. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19, dhe B 20 - lagjja "Mati 1", 2017-2025;
10. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPL "Hortikultura";
11. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Republikës së Shqipërisë;
12. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfothen";
13. Pyetje dhe përgjigje;
14. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së parë dhe të dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 39 (tridhjetë e nëntë) vota për, 6 (gjashtë) abstenime, (Flamur Shala, Qëndron Kastrati, Sami Boroci, Shefqet Sylejmani, Nenad Miladinoviçi, Teuta Krasniçi), u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së parë dhe të dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për caktimin e një anëtar i Komisionin komunal të aksionarëve në KRM "Prishtina".

Agim Gashi, në emër të GP LDK- së, e propozoi Shefqet Sylejmanin.

Visar Arifaj nga Partia e Fortë, e propozoi Mirlinda Sopin.

Genc Sherifi e propozoi kryesuesin, Halim Halimi, për aksionar në KRM "Pastrimi".

Kryesuesi tha se për anëtar të Komisionit të aksionarëve në KRM "Pastrimi", e kemi propozimin për Shefqet Sylejmanin, Mirlinda Sopin dhe Halim Halimin.

Kryesuesi konstatoi se për Shefqet Sylejmanin janë 26 (njëzet e gjashtë) vota për, 7 (shtatë) vota kundër, (Abetare Fazliu, Cuneyd Ustaibo, Kimet Zeqa, Mirlinda Sopi, Sami Boroci, Sofije Bunjaku, Visar Arifaj) dhe 1 (një) abstenim, (Nenad Miladinoviçi), ndërsa për Mirlinda Sopin janë 18 (tetëmbdhjetë) vota për, 17 (shtatëmbdhjetë) vota kundër, (Agim Gashi, Blerand Stavileci, Fisnik Osmani, Halim Halimi, Hazir Borovci, Hetem Kupina, Laura Zherka, Lirak Çelaj, Lirie Avdiu, Muhamet Selmani, Mustafë Krasniçi, Naime Osmani, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Shefqet Sylejmani, Shemsi Veseli, Vlora Dumoshi) dhe 1 (një) abstenim, (Rita Begolli).

Kryesuesi konstatoi se Shefqet Sylejmani u caktua anëtar i Komisionit komunal të aksionarëve të KRM "Pastrimi".

Pika e tretë

Shqyrtimi i Raportit tremujor financiar janar - mars 2017.

Lirak Çelaj tha se ne për këtë pikë të rendit të ditës refuzojmë të debatojmë pa prezencën e kryetarit.

Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Financave, tha se sa i përket raportit tremujor financiar janar-mars 2017, të hyrat vetanake janë në rritje. Realizimi të hyrave është i suksesshëm, ku vlen të cekem 36.30% taksa për lejen e ndërtimit, tatimi në pronën e paluajtshme 26.78%, taksa nga kadastri dhe gjeodezia 36.28%, taksa nga transaksioni në pronë, 38.50%, të gjitha këto përqindje janë për tremujorin e parë.

Fisnik Osmani tha se ne si GP i LDK-së refuzojmë që të diskutojmë për një raport, të cilin është dashur ta elaborojë dhe mbroj kryetari i Komunës.

Ylli Hoxha tha se LVV e përkrah këtë raport.

Mirlinda Sopi tha se GP i asamblistëve të AKR-së e ka analizuar mirë raportin tremujor buxhetor janar-mars 2017 dhe jemi të kënaqur sa i përket të hyrave të arkëtuara në këtë tremujor. Në parim jemi për.

Imer Rusinovci tha se GP i AAK-së e mbështet këtë raport tremujor buxhetor.

Feti Mehdiu bëri të ditur se znj. Kimet Zeqa tash e tutje është pjesë e AKR-së dhe e përkrahu raportin tremujor.

Abetare Fazliu tha se Lëvizja për Bashkim e përkrah raportin tremujor buxhetor janar - mars 2017.

Visar Arifaj tha se desha të pyes për fushat për të cilat përqindja e realizimit të të hyrave është 10%, kisha dashur me i ditur arsyet.

Cuneyd Ustaibo tha se e përkrah këtë raport.

Sylejman Pireva kërkoi një sqarim te institucionet, ndërmarrjet publike, ku janë dhënë pasqyra e të hyrave, në këtë rast biblioteka "Hivzi Sulejmani" dhe Teatri "Dodona".

Ai shprehu mendimin se nuk ka nevojë të futen bashkërisht të dyja, por të ndara, si çdo institucion në mënyrë të pavarur, që ne ta kemi të qartë sa është realizimi i njërit dhe i tjetrit institucion. Është një realizim mjaft i mirë i të hyrave në përgjithësi në këtë tremujor.

Besart Vllahinja, drejtori i Drejtorisë së Kulturës, tha se sa i përket shqetësimit të ngritur nga z. Pireva, dua ta them se prej 1 marsit 2017, është zgjidhur çështja e të hyrave të cilat realizohen nga biblioteka e qytetit "Hivzi Sulejmani" dhe nga teatri i qytetit "Dodona".

Deri në këtë periudhë ka qenë problem, sepse të dyja këto institucione varëse të Drejtorisë së Kulturës nuk kanë pasur llogari, d.m.th. nuk i kanë derdhur mjetet në llogarinë në thesar.

Muhamet Selmani parashtrroi pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Financave, se a mund ta kemi në dispozicion specifikimin për kodin buxhetor 1.2.4 nr. 12, shpenzimet të tjera kontraktuese, që kanë qenë të parapara 200 mijë euro për tërë vitin dhe janë shpenzuar 307 mijë e 595 euro, si dhe për kodin 3.2, nr. 10, shpenzime të tjera kontraktuese, prapë kanë qenë 300 mijë euro për tërë vitin, kurse në tremujorin e parë janë shpenzuar 133 mijë e 854 euro. Sipas informatave, nga viti i kaluar këto kryesisht janë kontrata që bëhen për shërbime me kontratë të veçantë për persona në punë.

Ismail Kokaj tha se është e vërtetë që është dalë se 307 mijë euro shpenzim merren prej kodit 13.460, të cilat në analitikën tonë buxhetore duhet të shpërndahen.

Kryesuesi konstatoi se më 19 (nëntëmbëdhjetë) vota për, 11 (njëmbëdhjetë) vota kundër, (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Besa Rafuna, Fisnik Osmani, Hasime Krasniqi, Hetem Kupina, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Mustafë Krasniqi, Naime Osmani, Shaip Hajrizi) dhe 1 (një) abstenim, (Halim Halimi), miratohet Raporti tremujor financiar janar - mars 2017.

Pika e katërt

Bartja e buxhetit të pashpenzuar të të hyrave vetanake nga viti 2016 në vitin 2017.

Ismail Kokaj tha se sa i përket totalit për bartje është 8 milionë e 746 mijë euro, analitikën e shpenzimeve, të cilën mendojmë me e shpenzuar gjatë vitit 2017, që është mjetet e bartura nga viti 2016, i kemi të shpjeguara përmes tabelës.

Agim Gashi tha se do të duhej të analizohej kjo pasqyrë e shpërndarjes së buxhetit, meqenëse ne kemi parë se janë disa fusha që nuk janë prekur. Në vitin 2016, kur e kemi bartur buxhetin e vitit 2015, e kemi paraparë një sasi të buxhetit prej 50 mijë euro për hartimin e një projekti për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në fshatrat periferike të komunës së Prishtinës, të cilat janë pa ujë të mjaftueshëm dhe shpeshherë shërbimet e Komunës dhe shërbimet tjera detyrohen të bartin ujë me cisterna.

Qëndron Kastrati tha se ne e përkrahim këtë bartje të buxhetit.

Muhamet Selmani tha se jam për bartjen e buxhetit, mirëpo vitin e kaluar kur kemi kërkuar në bartje që NP "Sport - Marketing" si rezultat i dëmeve të shkaktuara për mungesën e punës, janë propozuar në këtë Kuvend t'i transferohen 85 mijë euro dhe deri sot nuk kam informatë që ajo pagesë është ekzekutuar.

Përderisa ne e financojmë ndërmarrjen "Trafiku Urban" me mbi 1 milion e 300 mijë euro, pastaj ndërmarrjen "Termokos" me mbi 800 mijë euro, çfarë arsye ka që ato mjete nuk i japim si subvencion. Ato kryesisht kanë qenë mjete të cilat janë kërkuar për t'u mbuluar shpenzimet, si pasojë e mos punës së ndërmarrjes "Sport - Marketing".

Mirlinda Sopi tha se ne e përkrahim bartjen e këtyre mjeteve nga viti 2016 në vitin 2017, sepse ka bazë ligjore. Po ashtu te investimet kapitale dhe menaxhimi i kontratave, tek pika 2.1, ndërtimi i rrugëve në pjesët urbane dhe infrastruktura përcjellëse, a është e përcaktuar se cilat rrugë janë? Sa i përket arsimit mirëmbajtja e elektrikes në shkolla dhe mirëmbajtja e nyjave sanitare, a është e paraparë për cilat shkolla, sepse këtu ceket vetëm shkolla "Faik Konica" e nuk jemi në dijeni a po shkojnë krejt mjetet për këtë shkollë, apo edhe nëpër shkolla të tjera ku ka nevojë?

Tek pika tjetër "Implementimi i projektit bllok pas blloku", cili projekt është ky?

Imer Rusinovci tha se në parim e mbështesim këtë specifikacion të bartjes së mjeteve. Ndërsa te infrastruktura e rrugëve kemi një kërkesë, e cila mendoj se është më se e arsyeshme, sepse nuk shoh që është e planifikuar një rrugë, të cilën e kemi paraqitur edhe vitin e kaluar nga pjesa e Brainës, Kushevicës dhe Nishevcit.

Feti Mehdiu shprehu mendimin se duhet të investohet më shumë në atë pjesë sesa këtu në qendër, pra të merren masa me kohë për ata banorë me i stimuluar në mënyra të ndryshme.

Visar Arifaj tha se parimisht e përkrahim këtë vendim dhe desha të dijë për ndërtimin e bulevardit mbi kurriz, se kur parashihet të përfundojë ky projekt dhe cilat janë arsyet pse ka zgjatur kaq shumë.

Cuneyd Ustaibo u shpreh në përkrahje të buxhetit.

Bardha Dida - Rogova theksoi se, meqë Shkollës së Muzikës iu ka bërë vetëm një zgjidhje e përkohshme, duke u vendosur në objektin e shkollën "Dr. Ali Sokoli", a është përcaktuar vendi dhe a mendohet që këtë vit të ndërtohet objekti i kësaj shkolle? **Kryetari, Shpend Ahmeti**, tha se këtu kemi të bëjmë me vendim për bartje të buxhetit dhe bartja nënkupton se kemi të bëjmë me projekte të planifikuara në vitin e kaluar, duke konsideruar të hyrat që i kemi mbledhur deri në fund të vitit mbesin në buxhetin e vitit të kaluar.

Çështjen që e potencoi Muhameti do ta shqyrtojë në buxhetin e sivjetmë, mirëpo me bartje nuk mund të shtojmë as vija të reja buxhetore, mundësisht mund të bëhet përmes buxhetit të subvencioneve, të cilin e kemi të paraparë. Për pyetjen e Mirlindës, mendoj se janë të shpjeguara të gjitha ato investime kapitale, e ke shumë e përgjithshme, ndërtimin e rrugëve në pjesët urbane, i ke të gjitha projektet në tabela. Ne e kemi një kontratë për mirëmbajtje dhe ndërtim të nyjave sanitare për të gjitha shkollat, pastaj merren cilat shkolla e kanë gjendjen më të rëndë dhe më të keqe. Projekti bllok pas blloku është projekt që është zhvilluar me UN Habitat, është projekt në rrugën "B" të banesat e Standardit, ku janë marr propozimet e fëmijëve me programin "Main Kraft", që kanë shprehur dëshirë dhe prej atij diskutimi është bërë një propozim për ndërtimin e një parku të lojërave.

Për z. Rusinovci patjetër se do ta përcjell kërkesën, do të shohim mundësinë që ndoshta me buxhetin e sivjetmë, apo me rishikim të buxhetit ta parashohim edhe këtë. **Ajnishahe Azemi** tha se në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2016, kur kemi diskutuar për buxhetin e vitit 2017, kemi diskutuar për çështjen e personave me aftësi të kufizuara. Në atë seancë është vendosur me shumicë votash, që të jetë Qendra për qëndrim ditor për persona me nevoja të veçanta, ashtu qysh ka qenë e miratuar edhe në legjislaturën e kaluar. Në raport prapë po shënohet te shëndetësia, te shpenzime kapitale, ndërtimi i Qendrës për persona me nevoja të veçanta Syndrom Down dhe Autizëm, andaj kërkoj që kjo të korrigjohet.

Kimete Zeqa tha se Grupi i grave asambliste ka punuar për të mirën e atij komuniteti, e kanë përkrahur këtë Autizëm dhe Syndrom Down.

Lirak Çelaj tha se unë vetëm dua ta sqarojë, ne mund ta kthejmë si pikë të rendit të ditës, me debatuar, por kjo është vendosur. Pavarësisht a ka pakënaqësi, vendimi i Kuvendit është në fuqi.

Hatixhe Hoxha tha se nuk mundesh me i lënë të gjitha kategoritë bashkë me u ofruar trajtim tërëditor. Qe dy vjet janë duke pritur këto dy shoqata qëndrimet e Komunës së Prishtinës, me të holla të gatshme, donatorët edhe mund t'i tërheqin mjetet, duke pritur qëndrimet që po merren në Kuvend.

Kryesuesi Konstatoi se më 32 (tridhjetë e dy) vota për, 1 (një) abstenim (Ajnishahe Azemi), u miratua bartja e buxhetit të pashpenzuar të të hyrave vetanake nga viti 2016 në vitin 2017.

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).

Ardian Olluri theksoi se Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), i është drejtuar Komunës së Prishtinës me kërkesë për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale me procedurë të veçantë. Në kërkesë ata kanë sqaruar se është i nevojshëm investimi në fshatin Bardhosh, janë përpjekur të gjejnë pronë për ta blerë, por nuk kanë mundur, andaj iu kanë drejtuar Komunës me këtë kërkesë. Kryetari pasi që e ka shqyrtuar këtë kërkesë, e ka parë të arsyeshme se duhet bërë investime energjetike në fshatin Bardhosh, andaj dhe i propozon Kuvendit dhënien në shfrytëzim të pronës komunale kësaj kompanie përmes procedurës së veçantë.

Hetem Kupina, në emër të të gjithë qytetarëve që jetojnë në Bardhoshë, të cilët janë në hall të madh në mungesë të energjisë elektrike, tha se duhet t'u bëhet një zgjidhje këtyre qytetarëve.

Qëndron Kastrati paraqiti shqetësim lidhur me këtë propozim, sepse kërkohet t'i jepet prona komunale në shfrytëzim një korporate private pa asnjë kompensim.

Kjo duhet të jetë një pikë e veçantë, ku kjo pronë për këtë kohë që është e caktuar dhe mendohet t'i jepet, të mos konsiderohet si aset i kësaj korporate. Nëse kjo korporatë shitet, mos ta shfrytëzojë pronën komunale për përfitime financiare.

Lirie Avdiu, në emër të GP të PDK-së, dha pëlqimin për këtë pikë të rendit të ditës, por me kusht që të sqarohet periudha kohore në të cilën do të shfrytëzohet kjo hapësirë.

Mirlinda Sopi, në emër të GP të AKR-së, kërkoi prej Zyrës ligjore të shqyrtohet baza ligjore e votimit të mëhershëm sa i përket aksionarit në kompaninë "Pastrimi".

Ndërsa sa i përket pjesës së dhënies në shfrytëzim të kësaj parcele KEDS-it, ne si AKR jemi për aprovimin e kësaj pike.

Rita Begolli bëri të ditur përkrahjen e GP të AAK-së për miratimin e këtij vendimi.

Feti Mehdiu e përkrahu miratimin e kësaj pike.

Visar Arifaj u shpreh në përkrahje të miratimit të kësaj pike.

Nora Kelmendi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit, tha se nuk është dhënë e gjithë parcela në shfrytëzim, por vetëm 15 m², kështu që në aparatën kadastror evidentohet si pronë në shfrytëzim, pra nuk evidentohet si pronë e KEDS-it, mirëpo pronë të cilën e shfrytëzon KEDS-i për 15 vjet.

Kryesuesi pas konsultimeve me Zyrën ligjore, konstatoi se më 23 (njëzet e tri) vota për, 5 (pesë) abstenime, (Bardha Dida - Rogova, Genc Sherifi, Hatixhe Hoxha, Qëndron Kastrati, Teuta Krasniqi), nuk kalon Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me prona të paluajtshme të personave fizikë.

Me fillimin e vazhdimit të mbledhjes, Kryesuesi konstatoi se mbledhja do të shtyhet në mungesë të kuorumit.

Mbledhja u ndërpre në orën 14:05.

Vazhdimi i mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 19.05.2017, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi, shef i GP-së (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Shefqet Sylejmani (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hetem Kupina (LDK), Merita Surkishi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Berat Lahu (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemi Veseli (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Egzona Podvorica (PDK), Mirlinda Sopi, shefe e GP-së (AKR), Sami Boroci (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Kimet Zeqa (AKR), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, përfaqësues i subjektit politik (PD), Abetare Fazliu, përfaqësuese e subjektit politik (LB), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Munguan: Vjollca Dibra - Ibrahim (LDK), Flamur Shala (LDK), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Blerand Stavileci (PDK), Shaip Shabani (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF) dhe Abit Kastrati.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimin e pikave të rendit të ditës, kryesuesi kërkoi një minutë heshtje me rastin e vdekjes së deputetit të Kuvendit të Kosovës z. Agim Kika.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me prona të paluajtshme të personave fizikë.

Ardian Olluri bëri të ditur se janë dy propozime për këmbimin e pronave. Në rastin e parë është propozuar këmbimi i pronës komunale me pronën në pronësi të personave fizikë, ndërmarrjes "Al Trade" dhe Bajram Gashanit. Në pronën private është planifikuar ndërtimi i shkollës dhe parkut gjelbërues. Pasi që mjetet janë siguruar nga buxheti, kryetari i Komunës i ka propozuar Kuvendit këmbimin e pronës komunale me këtë pronë private. Kjo veç është shqyrtuar njëherë nga Kuvendi gjatë vitit të kaluar, mirëpo në atë mbledhje është konstatuar se ka pengesa ligjore për këtë këmbim, për shkak se prona private ka qenë e ngarkuar me barrë hipotekare, ndërsa tani barra është hequr nga prona private dhe janë plotësuar kushtet për këmbimin e pronës.

Agim Gashi shprehu qëndrimin se në rast se në aspektin e ligjshmërisë nuk ka ndonjë pengesë, ne pajtohemi që ky ndërrim i pronave të bëhet mbi bazën ligjore.

Ylli Hoxha tha se LVV-ja e përkrah miratimin e propozimit.

Lirak Çelaj pyeti se a ka të drejtë Kuvendi të marrë vendime të tilla pas datës 15 maj. Po ashtu, kërkoi sqarim edhe njëherë, me numër të parcelave, të dihet saktësisht se për cilin vend është fjala.

Sami Borovci tha se GP i AKR-së e përkrah vendimin për këmbimin e pronës.

Imer Rusinovci tha se nëse materiali i ka kaluar të gjitha procedurat normale që i kërkojnë aktet normative, andaj dhe e përkrahim.

Abetare Fazliu, në emër të LB-së e përkrahu miratimin e vendimit.

Visar Arifaj, e përkrahu miratimin e kësaj pike.

Ardian Olluri për pyetjen e bërë nga asamblisti Lirak Çelaj, tha se kufizimi në gjashtë muajt e fundit të mandatit është vetëm për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë, kufizime të tjera nuk ka. Shkolla është planifikuar të ndërtohet në lagjen "Qëndresa".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, me 40 (dyzet) vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të ndërmarrjes "AL Trade" sh.p.k. dhe Bajram (Nasuf) Gashanit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, me 40 (dyzet) vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve: Fatime (Hasan) Hajrizi, Ali Aliu, Ilir (Fetah) Fetahaj dhe Fetah (Rexhë) Fetahaj.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për lënien në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re" - Zona Lindje.

Sadri Ramabaja u shpreh se jam banor i zonës së Zillatarit dhe desha të pyes lidhur me përroin e Matit. Sipas Planit zhvillimor urban, aty ka qenë e paraparë një rrugë prej 22 m, ka qen projekt i ngutshëm, i cili e prish komplet lagjen ku jam unë. Si është përceptuar kjo, sepse me katër korsi është paraparë prej spitalit e deri te restorant "Kulla".

E dyta, ka të bëjë me një projekt që ka qenë i ideuar, në fakt edhe një gurthemel i famshëm, ka qenë vendosur në ato kodrat për të ashtuquajturën Qendër Përkujtimore të Nënë Terezës.

Muhamet Selmani pyeti se kjo zonë urbane që po duket në hartë, pjesët që janë veri, jug, lindje dhe perëndim, a janë përfshirë në Planin zhvillimor të Komunës, apo kanë mbetur jashtë planeve. Nëse është e mundur me i përfshirë këto, a janë të parapara si gjelbërim, apo parashihet prapë me e bërë një plan tjetër për një parcelë tjetër.

Mirlinda Sopi tha se ne jemi në mbështetje të planeve rregulluese, pavarësisht këtyre konflikteve që janë në mes të Ministrisë dhe Komunës.

Rita Begolli tha se GP i AAK-së e përkrah këtë vendim.

Feti Mehdiu u shpreh se e përkrahim, por me kushtin që do të përcillet në diskutim publik. Ai pati dhe një sugjerim. Aty ku u përmend prona private, prona shoqërore, prona komunale, me pasur kujdes më shumë, sepse ajo prona komunale që i themi sot, ose prona shoqërore, mund të prekë dike në pronën individuale.

Abetare Fazliu tha se LB-ja e përkrah propozimin.

Shemsi Veseli tha se, meqë e patët krijuar përshtypja se po i ndalojmë, po i ngufatim këto gjëra, unë prapë do t'i bashkëngjitëm grupit dhe do të votoj për.

Shefki Gashi theksoi se ky propozim duhet të shkojë në diskutim publik, por gjithmonë duhet të merren parasysh interesat e qytetarëve.

Agim Gashi tha se GP i LDK-së nuk e pengon zhvillimin e këtyre projekteve, por do të ishte mirë të na shpjegohet nga Zyra ligjore se po bëjmë apo nuk po bëjmë shkelje ligjore, sepse ne nuk do ta pengojmë këtë proces.

Ylli Hoxha theksoi se plani rregullues bëhet sipas një vendimi të marrë nga kjo asamble. Ekziston Plani zhvillimor urban, i cili i përcakton kufijtë dhe thotë këtë ndërtim, këtë destinacion, këtë sipërfaqe mund ta bësh.

Ardian Olluri dha sqarime të nevojshme lidhur me këtë pikë.

Sylejman Pireva tha se duhet bërë zgjidhjen më të mirë, duke besuar se gjithçka ka kaluar përmes ekspertëve.

Lirak Çelaj u shpreh se duhet të shikohet gjendja faktike në terren, sepse për këtë arsye po krijohen probleme. Raste të tilla kemi edhe në lagje të tjera, ku është bërë plani shkel e shko dhe nuk është marrë parasysh gjendja faktike në terren.

Burbuqe Hydaverdi, përfaqësuese e Drejtorisë së Urbanizmit, dha sqarime të nevojshme për pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se më 24 (njëzet e katër) vota për, 2 (dy) vota kundër, (Muhamet Nura, Shefki Gashi), 7 (shtatë) abstenime, (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Besa Rafuna, Hasime Krasniqi, Laura Zherka, Merita Surkishi, Lirak Çelaj), u miratua Vendimi për lënien në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishtëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re" - Zona Lindje.

Pika e tetë

Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1".

Shkurta Pacolli, përfaqësuese e Kompanisë "A Design", në mënyrë elektronike bëri prezantimin e Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1", duke zbërthyer disa nga komponentët kryesor të këtij plani.

Mustafë Krasniqi tha se si vendim i grupit është i njëjtë me vendimin paraprak, sigurisht se do të përkrahjet, pastaj është çështje e Ministrisë se çfarë mendimi jep.

Ylli Hoxha u shpreh në përkrahje të këtij propozimi.

Lirak Çelaj kërkoi sqarim nga prezantuesja e planit lidhur me etazhitetin.

Shkurta Pacolli, përfaqësuese e Kompanisë, bëri të ditur se përgjatë rrugës "Vëllezërit Fazliu" është paraparë ndërtim në etazhitet 10-15, 15 etazhe, d.m.th. vetëm janë të përcaktuara, koeficientet janë marrë minimalë. Koeficient maksimal mund t'u jepet atyre që janë të interesuar, nëse japin diçka ndërtim për interesa publike, shoqërore, ndoshta gjelbërim, ndoshta ndonjë çerdhe, atëherë mund t'i jepet koeficienti maksimal përgjatë rrugës "Vëllezërit Fazliu".

Pjesa tjetër është 5-6 etazhe, kjo këtu e cila është ndërtim i mesëm i përzier, pjesa tjetër afër saj shkon me etazhitet qysh është 3-4, e cila llogaritet si banim i mesëm, banim kolektiv dhe pjesa tjetër janë banim individual, pjesa e cila veç tash është e lirë nuk është shumë e ndërtuar.

Burbuqe Hydaverdi, përfaqësuese e Drejtorisë së Urbanizmit, në pika të shkurtra i njoftoj të pranishmit lidhur me etazhitetin.

Sadri Ramabaja tha se jam dakord që etazhiteti i mesëm, siç e prezantoi Liraku, të ngrihet për të rritur interesin e qytetarëve. T'i jepet një pamje tjetër qytetit, por, natyrisht, të respektohen distancat, jo aty ku është distanca e domosdoshme e paraparë sipas planeve tuaja profesionale të zvogëlohet përtej minimumit dhe më pas të kemi një katrahurë të kësaj natyre.

Ylli Hoxha, sa i përket lagjes "Kodra e Trimave", theksoi se është mirë ndërtimi të jetë i lartë, sepse infrastruktura e rregullimit të asaj lagje është e pashpresë nëse nuk bëhet një transformim radikal, por nuk e kemi të drejtën prej kësaj pike ta bëjmë atë transformim. Ne mundemi ta diskutojmë atë plan, të flasim për ndryshimin e planit zhvillimor, i cili e parapërcakton ose hartën zonale e cila e mundëson pastaj planin e hollësishëm të jetë në atë drejtim.

Shemsi Veseli ceku se duhet të bëhet një plan që parasheh perspektivë. Meqë ato janë shtëpi shumë të dendura, që të jetë etazhiteti shumë më i lartë, që të krijohet mundësia me pasur rrugë më të gjëra, me pasur gjelbërim, me pasur infrastrukturë përcjellëse, kjo formë tash do ta bllokojë plotësisht lagjen "Kodrën e Trimave" për këto pesë vjet. Pajtohem me atë që e tha Ylli Hoxha, se është Plani zhvillimor urban dhe komunal.

Ai kërkoi të dijë arsyen e vonesës së planit të lagjes "Kodra e Trimave" nga viti 2008 deri në vitin 2017.

Burbuqe Hydaverdi tha se kjo është hartuar në vitin 2013.

Laura Zherka shprehu mendimin se kemi plane të dobëta, për shkak se nuk kemi shkuar me hartimin e Planit zhvillimor komunal, e njëjta gjë po ndodh edhe tash. Nuk do të kemi plane të mira dhe të zbatueshme pa i miratuar hartat zonale, kështu që mua më mbetet vetëm me abstenuar, për të mos thënë se po i bllokojmë këto plane rregulluese.

Agim Gashi tha se për të respektuar procedurat për zhvillimin e planeve rregulluese, zhvillimin dhe ndryshimin e tyre, bazë është harta zonale.

Muhamet Selmani kërkoi sqarim për parcelat e planifikuar sipas planit, a ka hapësirë që ne si Komunë dhe toka komunale apo shoqërore që gjenden përreth parcelës, me e zgjeruar planin urban, do të bënim njëfarë shpërndarje të parcelës apo koeficientit, që kishte me e ndihmuar realizimin e projektit. Shembull konkret, mund të bëjmë kombinime të tokës ose ndërtesave në zonën që janë toka të Komunës, pastaj me i zhvendosur koeficientet që me qenë sa më i leverdishëm si projekt.

Ajnishahe Azemi shprehu mendimin se ky plan vërtet ishte dashur të rregullohej me kohë, të hartohej me një etazhitet, i cili ju ofron kushte për një jetë më të mirë të gjithë qytetarëve. Jo me qenë vetëm për ata që janë rreth rrugës, kurse këta të tjerët me pasur një etazhitet i cili nuk u siguron kushte që mund të jenë në favor të tyre.

Hatixhë Latifi - Pupovci u shpreh se një prej arsyeve pse është shtyrë krejt ky realizim, është mos përpilimi i Rregullores ose i Udhëzimit administrativ për hartat zonale. Besoj se diku rreth tri vjet i kanë shkuar Ministrisë për ta hartuar këtë Udhëzim administrativ.

Genc Bashota, drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se nëse e bllokojmë këtë plan dhe e presim hartën zonale, asgjë nuk kemi përfituar prej këtij rasti, sepse nuk bllokohet ky pesë vjet dhe nuk konservohet si i tillë që të jetë i paprekshëm kur të vjen harta zonale.

Sa për sqarim, nuk mundem me ju dhënë ndonjë datë të saktë, por mundem me ju siguruar se një muaj nuk janë në pyetje, por pak më shumë, është një proces shumë më kompleks i hartave zonale.

Kryesuesi konstatoi se më 18 (tetëmbëdhjetë) vota për, 6 (gjashtë) vota kundër, (Egzona Podvorica, Lirak Çelaj, Muhamet Nura, Mustafë Krasniqi, Shefqet Sylejmani, Shemsi Veseli), dhe 7 (shtatë) abstenime, (Ajnishahe Azemi, Besa Rafuna, Feti Mehdiu, Laura Zherka, Merita Surkishi, Muhamet Selmani, Halim Halimi), u miratua Vendimi për miratimin e planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1".

Pika e nëntë

Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20 - lagjja "Mati 1", 2017 - 2025.

Laura Zherka tha se ky vendim është i përsëritur, trajtimi i sipërfaqes prej 21.68 hektarësh është sipërfaqe e vogël për t'u kategorizuar si plan rregullues i hollësishëm, pa e përfshirë edhe zonën përreth, sipërfaqen që është në pronësi të Komunës apo në pronësi të agjencisë ose AKP-së. Lidhur me planin e prezantuar, është me interes të dihet se kush i përfaqëson pronarët, kush e ka lidhur kontratën në mes të studios "Libenskin" dhe përfaqësuesit, a është kompania apo është Komuna, se projekti është pikërisht i tyre.

Ardian Olluri tha se sa i përket shkresës, është e vërtetë që ajo ka ardhur, është sjell vendimi në Kuvend prapë për rishqyrtim duke u bazuar në atë shkresë dhe Kuvendi e ka lënë në fuqi. Pas atij vendimi të Kuvendit, është marrë vendimi për vënien në dispozicion për diskutim publik të planit, për të cilin nga Ministria nuk na është kthyer asnjë përgjigje, dhe është në fuqi. Sa i përket çështjes së konkursit publik kur është marrë vendimi për fillimin, investitori ka kërkuar leje për një sipërfaqe të madhe, duke u thirrur se ka marrëveshje me të gjithë ata pronarë. Duke qenë se sipërfaqja ka qenë shumë e madhe, Drejtoria e Urbanizmit ka kërkuar të bëhet një konkurs, i cili e planifikon atë ndërtim në sipërfaqe aq të madhe.

Lirak Çelaj pyeti përfaqësuesin e Zyrës ligjore se a është marrë në pyetje apo është në hetime kryetari për këtë rast. Pse nuk na janë sjellë neve këtu me dokumentacion edhe memorandumit që është nënshkruar paraprakisht, pse nuk janë sjellë nënshkrimet apo lista e gjithë pronarëve që e kanë nënshkruar dhe kur e kanë nënshkruar. Pra, proceduralisht mendoj se ka shkelje ligjore.

Ardian Olluri tha se nuk jam në dijeni se a është duke u hetuar dikush për këtë punë. **Sylejman Pireva** ceku se, meqë jam banorë i kësaj lagje, më intereson të dijë se çka ka ndodhur dhe çka do të ndodh me ndërtimet e mëhershme, të cilat nuk kanë qenë kur është përpiluar ky projekt, dhe a janë në harmoni me këtë projekt.

Shemsi Veseli tha se unë nuk e dëgjova sa është kostoja e realizimit të kësaj pjese, a ka bërë farë analizë urbanizmi etj. Më e dhimbshme është se asnjëherë, për asnjë plan që po bëhet propozim-ndryshimi, nuk është bërë evalvimi i tyre, me u konstatuar sa kanë qenë, në çfarë shkalle të realizimit janë, cilat kanë qenë pengesat, cilat kanë qenë forcat shtytëse për ta zbatuar atë plan, nuk ka një analizë të tillë.

Burbuqe Hydaverdi, përfaqësuese e Drejtorisë së Urbanizmit, dha sqarime të nevojshme lidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se më 14 (katërmëdhjetë) vota për, 10 (dhjetë) vota kundër (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Fadil Gashi, Halim Halimi, Hasime Krasniqi, Imer Rusinovci, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Shaip Hajrizi, Shemsi Veseli), 7 (shtatë) abstenime, (Besa Rafuna, Feti Mehdiu, Laura Zherka, Muhamet Selmani, Naime Osmani, Remzi Pacolli, Rita Begolli) nuk u miratua Propozimvendimi për miratimin e planit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20 - lagjja "Mati 1", 2017 - 2025.

Berat Lahu ngriti shqetësim rreth votimit të kësaj pike dhe kërkoi interpretim nga Zyra ligjore.

Ardian Olluri tha se duke pasur parasysh kuorumin, kjo pikë nuk kalon.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPL "Hortikultura".

Ardian Olluri sqaroi se është një kërkesë nga "Hortikultura" për dhënie në shfrytëzim të një parcelë komunale, me qëllim të ngritjes së fidanishtes, e cila do të përdoret si bazë për kultivimin e fidanëve dhe luleve, me qëllim të gjelbërimit të qytetit.

Kryetari i Komunës duke u bazuar në Ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, i ka propozuar Kuvendit dhënien në shfrytëzim afatgjatë të kësaj parcele.

Agim Gashi tha se ne e përkrahim këtë vendim për dhënien në shfrytëzim për ndërmarrjen komunale, por dikur ky Kuvend i Komunës ka bërë ndarjen e një lokacion "Hortikulturës". Në qoftë se ai vendim është në fuqi, është mirë të anulohet ai vendim, pastaj t'i ndahet lokacioni i ri për të njëjtin destinim. Nëse afati për marrjen e vendimeve për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë ka përfunduar më 15 maj, jashtë kësaj date nuk ka bazë ligjore. Nëse dëshirojmë t'i ndihmojmë ndërmarrjes "Hortikultura", ia japim për 15 vjet, nëse jo, ne jemi kundër, sepse nuk dëshirojmë të votojmë kundërligjshëm.

Egzona Podvorica shprehu mendimin se, përderisa neve nuk na njohin si organe, as bordin, këtë propozimvendim nuk e përkrahim.

Sami Boroci tha se GP i AKR-së e përkrah propozimin.

Abetare Fazliu në emër të LB-së, e përkrahu këtë kërkesë për "Hortikulturën".

Ardian Olluri bëri të ditur se Zyra ligjore e ka informuar ekzekutivin për këtë çështje dhe ka kërkuar ndryshimin e propozimit.

Ekzekutivi nuk është pajtuar me mendimin e Zyrës ligjore, mendon se ky është vazhdim i mbledhjes së dt. 15.05.2017, dhe jemi në pajtim me ligjin. Është kërkuar që Kuvendi të vendosë për propozimin e tyre dhe për këtë le të vlerësohet ligjshmëria nga Ministria.

Teuta Krasniqi tha se këto pika kanë qenë në rend të ditës më 15.05.2017, atëherë është e njëjta mbledhje, por pse ato u pranuan e këto nuk po pranohen!

Remzi Pacolli u shpreh se, nëse vendimi votohet sot, ai vendim e merr datën e sotme, jo të 15 majit. Atëherë të jemi të vetëdijshëm se a po votojmë në suaza të ligjit.

Kryesuesi konstatoi se më 17 (shtatëmbëdhjetë) vota për, 16 (gjashtëmbëdhjetë) vota kundër, (Agim Gashi, Besa Rafuna, Egzona Podvorica, Halim Halimi, Hasime Krasniqi, Hetem Kupina, Laura Zherka, Lirak Çelaj, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Muhamet Selmani, Mustafë Krasniqi, Remzi Pacolli, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Shemi Veseli), nuk u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPL "Hortikultura".

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ambasadës së Republikës së Shqipërisë.

Ardian Olluri dha sqarime rreth këtij propozimvendimi, duke thënë se prapë është çështja e afatit, është qëndrimi i njëjtë i ekzekutivit, kërkon të votohet në Kuvend.

Agim Gashi kërkoi nga Zyra ligjore të japin sqarime juridike ashtu si e parasheh ligji. Nëse është në kundërshtim me ligjin, mos na qitni në lajthitje.

Mirlinda Sopi theksoi se për ndarjen e parcelës për Ambasadën e Shqipërisë, GP i AKR-së veç e ka dhënë qëndrimin dhe jemi për ndarjen e kësaj parcele.

Ylli Hoxha tha se ne konsiderojmë që kemi qenë për, siç kemi qenë edhe herëve të tjera kur ka qenë ky propozim. Është çështje e cila duhet të kryhet.

Lirak Çelaj u shpreh se nuk kisha pasur dëshirë të ndërtohet Ambasada e Shqipërisë në një tokë ku ka kontest, megjithatë ne do ta përkrahim si GP.

Imer Rusinovci e përkrahu miratimin e kësaj pike.

Abetare Fazliu e përkrahu miratimin.

Shefki Gashi tha se është bërë ndarja e parcelës, por nuk është e mundur të njëjten pronë dy palëve me ua dhënë në shfrytëzim për ndërtim.

Kryesuesi tha se pas datës 15 maj, sipas shkresës, nuk kemi të drejtë të japim prona në shfrytëzim në kohë afatgjate dhe duhet t'i bëhet kërkesë Ministrisë së Punëve të Jashtme nga ana e Shqipërisë, pastaj Qeveria duhet t'i drejtohet Komunës.

Ardian Olluri bëri të ditur se është caktuar lokacioni, toka nuk i është dhënë LDK-së në shfrytëzim, pastaj është dashur me u marrë një vendim për dhënien në shfrytëzim dhe me u nënshkruar një kontratë, prona është ende e Komunës, pa të drejta të një pale tjetër mbi atë pronë. Vendimi ka qenë caktim i lokacionit për ndërtimin e selisë së LDK-së.

Sadri Ramabaja u shpreh se, desha t'u drejtohem kolegëve të LDK-së, sepse pjesa tjetër po duket qartë që ka vendosur që të votojë për. Për ju si grupim politik do të ishte relativisht keq të pozicionoheni kundër këtij vendimi.

Kryesuesi konstatoi se më 22 (njëzet e dy) vota për, 1 (një) votë kundër, (Halim Halimi) 2 (dy) abstenime, (Agim Gashi, Mustafë Krasniqi), nuk miratohet propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ambasadës së Republikës së Shqipërisë.

Pika e dymbëdhjetë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfoten".

Adrian Olluri informoi se kjo organizatë ka kërkuar që t'i jepet në shfrytëzim prona për një afat më të gjatë. Ju jeni të informuar që aktualisht e ka në shfrytëzim aty një pjesë të pronës ku është i ndërtuar kopshti i arinjve. Kryetari duke u bazuar në Ligjin për dhënien në shfrytëzim, i ka propozuar Kuvendit që të jepet në shfrytëzim kjo pronë për periudhë afatgjate.

Situata është e njëjtë të të tri vendimet ku është kërkuar që të ndryshohet propozimi. Ekzekutivi nuk e ka ndryshuar, sepse pretendon që kjo është vazhdim i mbledhjes së 15.05.2017 dhe nuk jemi në kundërshtim me ligjin.

Agim Gashi ceku se ne kemi të drejtë të marrim vendim vetëm deri në 15 vjet dhe nuk kemi të drejtë për 99 vjet, sepse e kemi humbur afatin ligjor. Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve i hynë në punë edhe propozimi për 15 vjet, sepse ndërlidhet me një donacion për vazhdimin e investimeve në atë vend. Fjala është për ndërtimin e Qendrës Edukative Ambientale, dhe ka interes, sepse punësohen njerëz të Komunës së Prishtinës dhe është projekt me interes të përgjithshëm.

Kryesuesi konstatoi se më 18 (tetëmbëdhjetë) vota për, 1 (një) votë kundër, (Halim Halimi) 5 (pesë) abstenime, (Mustafë Krasniqi, Teuta Krasniqi, Berat Lahu, Merita Surkishi, Shefki Gashi), nuk u miratua propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfofen".

Pika e trembëdhjetë
Pyetje dhe përgjigje

Sadri Ramabaja kërkoj sqarim nga kryesuesi, duke thënë se në pikën kur votuam për dhënien në shfrytëzim të tokës për Ambasadën, dua të di se si keni votuar ju, sepse përcaktuese ka qenë vota e juaj, dhe t'i jepni përgjigje jo vetëm këtij Kuvendi, por edhe qytetarëve.

Kryesuesi tha se unë e kam zbatuar dhe e zbatoj ligjin gjithëherë. Unë qysh kam votuar është çështje e imja.

Abetare Fazliu kërkoj të di se si është e rregulluar me ligj çështja e pagesës në trafikun urban për ushtarët dhe policët, meqenëse policët nuk paguajnë, ndërsa ushtarët bëjnë pagesë.

A ekziston mundësia që të dy palët të mos bëjnë pagesë në trafikun urban.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Procesmbajtësja
Luljeta Selimi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dip.